

# Mosmarrëveshjet ndërpartiake lënë të bllokuara komitetet prej 6 muajsh

Arian Duriqi

LIPJAN, 15 QERSHOR – Me përjashtim të Komitetit për Politikë e Financa, komitetet e tjera obliguese në Lipjan janë kapur nga një bllokade pothuajse gjashtëmuajshe, përderisa funksionalizimi i tyre po vonon si rezultat i pakënaqësisë së opozitës me numrin e ofruar të ulëseve në komitete. Për më tepër, me gjithë faktin se drejtues të KK-së e kanë ftuar PDK-në që të sjellë emrat e anëtarëve të tyre për plotësimin e komiteteve dhe daljen nga ngërçi, nga ana tjetër vetë krerë të subjektit më të madh opozitar në Lipjan tash për tash e kanë refuzuar këtë për faktin se, sipas tyre, po tentohet të hidhet baltë mbi faktin se PDK-ja është partia më e madhe në Lipjan që rrjedhimisht ka edhe numrin më të madh të këshilltarëve në KK. Florent Hoxha, nënkryetar i PDK-së në Lipjan, njëherësh edhe këshilltar komunal, ka thënë se nuk do të ketë marrëveshje për përfaqësim në komitete përderisa pozita nuk e kupton faktin se PDK-ja ka numrin më të madh të këshilltarëve në KK dhe se duhet të përfaqësohet si forca e parë në komitete.

“Përberja e komiteteve duhet të shkojë sipas pikëve që ka përcaktuar niveli qendror bazuar në numrin e këshilltarëve në KK. Ne në KK të Lipjanit kemi numrin më të madh të këshilltarëve, ndërsa nga kryetësia e Kuvendit dhe nga pjesa tjetër e pozitës nuk është përfillur ky fakt dhe kjo është arsyeja që me shpërfillje nuk shkojnë drejt zgjidhjes. PDK-ja është e gatshme të zh-

bllokojë komitetet, por vetëm duke respektuar forcën në KK”, ka thënë Hoxha.

Ndërkohë që një evidencim të kësaj gjendjeje e ka publikuar kohë më parë edhe shoqëria civile në Lipjan. Organizata joqeveritare YAHR (Youth Association for Human Rights), tekta ka publikuar raportin e monitorimit të punës së Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit gjatë periudhës janar - qershor 2014 ka evidencuar ngërç të madh në funksionimin e komiteteve që funksionojnë në kuadër të KK-së. Edhe aty është thënë se me përjashtim të Komitetit për Politikë e Financa (KPF), komitetet e tjera janë kapluar nga “paraliza”.

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, është shprehur me këtë rast se mosfunksionimi i komiteteve, sipas tij, ka kaluar çdo kohë për normalizim të tyre.

“Në hulumtimin që kemi kryer kemi konstatuar mosefikasitet të punëve të komiteteve të formuara me përjashtim të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ky fakt nuk çon në drejtim të mirë të demokracisë, por përkundrazi e ngufat atë”, ka thënë Krasniqi.

E nga ana tjetër, sipas krerëve të KK-së, ndarja e ulëseve nëpër komitete është krejt në rregull. Alban Nuredini, zëdhënës i Lipjanit, ka deklaruar se ndarja e ulëseve është bërë në raport me numrin që zotojnë subjektet politike në KK.

“Këtë e ka legjitimuar edhe MAPL-ja gjatë shqyrtimit të ligjshëmrisë së këtij veprimi. Nga ana tjetër, është kërkuar edhe publikisht



Florent Hoxha, nënkryetar i PDK-së në Lipjan, njëherësh edhe këshilltar komunal, ka thënë se nuk do të ketë marrëveshje për përfaqësim në komitete përderisa pozita nuk e kupton faktin se PDK-ja ka numrin më të madh të këshilltarëve në KK

në seanca të KK-së nga grupi i këshilltarëve të PDK-së që të propozojnë emrat para kuvendarëve për ato vende të cilat u takojnë, gjithmonë duke u mbështetur në vendimin e MAPL-së, por PDK-ja nuk i ka sjellë propozimet”, ka thënë Nuredini. Ky ka qenë i mendimit se është koha e fundit që PDK-ja të reflektojë rreth përbërjes së komiteteve, pasi që, sipas tij, s’ka më asnjë arsye për bojkot komitetesh.

© KOHA Ditore

## Kryetari Ahmeti ua merr të drejtën e prononcimit drejtorëve komunalë dhe kryesueses

LIPJAN, 15 QERSHOR – Kryetari i Lipjanit, Imri Ahmeti, ka kohë që ua ka marrë të drejtën e prononcimit publik të gjithë drejtorëve komunalë pa pëlqimin paraprak të tij, derisa të drejtën e prononcimit e ka rezervuar për vete dhe për zëdhënësin komunal, Alban Nuredini. Madje, as kryesuesja e KK-së, Vlora Limani – Hajnuni, nuk prononcohet për medie, por këtë e bën vetëm nëpërmjet zëdhënësit, Nuredini. E ky veprim nuk është parë me sy të mirë as nga shoqëria civile në Lipjan. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka vlerësuar se kjo nuk i shërben transparencës dhe demokracisë në asnjë moment.